

MUHARREM DEZHGIU

**DIASPORA SHQIPTARE NË AMERIKË  
NË MBËSHTETJE TË ÇËSHTJES KOMBËTARE  
GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE\***

Pushtimi i Shqipërisë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, u përjetua me dhimbje e dëshpërim të thellë nga të gjithë shqiptarët, brenda e jashtë saj, nga diaspora e shpërndare në të gjithë botën. Në kumtesën tonë do të vëmë në dukje, në mënyrë të posaçme, qëndrimin që mbajtën shqiptarët e Amerikës ndaj pushtimit të huaj si dhe përgjegjësinë e tyre për t'i dhënë mbështetjen me të drejtë çështjes kombëtare, gjatë dhe pas Luftës Botërore.

Duhet vënë në dukje, që në fillim se, diaspora shqiptare në Amerikë, pati një veçori, referuar asaj të Evropës. Në Amerikë vepronin intelektualë shqiptarë të njohur, të cilët e njihnin historinë e Shqipërisë, që në themelet e shtetit të pavarur. Ata i kishin njohur në vazhdimësi peripecitë dhe pengesat nëpër të cilat kishte kaluar çështja shqiptare, deri në pushtimin e fundit Italian. Figura të njohura politike shqiptare kishin shprehur pikëpamjet e tyre për këto probleme, në vijimësi, nëpërmjet veprimtarisë së njohur të organizatës panshqiptare "Vatra" dhe në faqet e organit të saj, gazetës "Dielli". Duke qenë një veprimtari, e zhvilluar larg ambicieve dhe interesave të ngushta të ditës, ishte më e besueshme dhe më e paanshme, për t'u marrë në konsideratë mendimi i tyre, si mendimi më racional, në qëndrimin ndaj çështjes shqiptare.

Duke vepruar në Amerikë, në një nga vendet demokratike perëndimore, me një hapësirë më të gjerë, për veprimtari më frutdhënëse diplomatike mbi çështjen shqiptare, në kundërshtim me hermetizmin evropian për këtë çështje, e bënte më të favorshëm rolin e diasporës shqiptare në Amerikë, në mbështetje të çështjes kombëtare gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Shqiptarët e Amerikës u shprehën të vendosur për të demaskuar propagandën e shfrenuar dhe bajate që bëri imperializmi italian për qëllimet e pushtimit të Shqipërisë, për të joshur e për t'i tërhequr shqiptarët në aventurat e tij në Ballkan e më gjerë. Propaganda fashiste shpërndau harta të Shqipërisë, kufijtë e së cilës shkonin deri në Janinë, Selanik, Manastir e Shkup. Në faqet e shtypit shqiptar në Amerikë shprehej qartë se pushtuesit nuk i kërkonin këto

---

\* Kumtesë e mbajtur në *Seminarin III Ndërkombëtar të Albanologjisë*, organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, Shkup, 23-27 shtator 2009.

vende se janë vende shqiptare dhe duhet t'i kthehen Shqipërisë, por kanë ndërmend t'i grabitin për vete, sikundër grabitën Shqipërinë e lirë<sup>1</sup>.

Duke vazhduar më tej analizën e situatës përpara së cilës ndodheshin shqiptarët dhe për t'i orientuar me drejt bashkatdhetarët e tyre në Shqipëri, diaspora e bënte të qartë se “Shqiptarët edhe pse nuk e duan fashizmin s’kanë fuqi ta kundërshtojnë Italinë”. Por, nga ana tjetër, duke e njohur në mënyrë objektive këtë situatë, shqiptarët e Amerikës dënonin atë takëm shqiptarësh, siç i quanin “shpirtkalbur”, të cilët shiteshin për para, për t'i bërë varrin Shqipërisë. Nën ndikimin e këtyre njerëzve, populli ishte i shtrënguar të vishte këmishën e zezë dhe të thërriste “rroftë” për këtë ose për atë eksponent fashist<sup>2</sup>. Për shqiptarët e Amerikës slogani fashist se “Shqiptarët duhet të luftojnë për madhimin e vendit të tyre”, ishte një mashtrim i komandës italiane, për t'i motivuar ata e t'i çonte në vijën e parë të frontit të luftës, që të vriteshin për interesat e Italisë. Dhe me të vërtetë, kështu ndodhi me ato reparte shqiptare që u mobilizuan në frontin e luftës italo-greke, të cilët u vendosen në vijën e parë të sulmit, por që shumë shpejt dezertuan. Diaspora shqiptare bënte dallimin e administratës fashiste në Shqipëri nga populli shqiptar. “Bota e di fort bukur se sot s’ka Shqipëri, as guverne shqiptare, - bënte të njohur “Dielli”, por ajo është një koloni e vogël e Italisë. Për rrjedhojë, për të gjitha sulmet që ndërmori Italia ndaj fqinjëve të Shqipërisë, s’kishte faj as Shqipëria e as populli i saj”<sup>3</sup>.

Në periudhën fillestare të pushtimit të Shqipërisë, politika dhe diplomacia ndërkombëtare shpалosi një qëndrim të dyshimtë dhe të papërgjegjshëm për pavarësinë dhe integritetin territorial për Shqipërinë e pasluftës. Në mënyrë të veçantë një qëndrim i tillë vihej re në politikën dhe diplomacinë britanike. Prandaj, diaspora shqiptare në Amerikë dhe në Britaninë e Madhe, filloi të ushtronte presion ndaj qeverive të tyre, që ata të pranonin dhe të mbështetnin pa mëdyshje rimëkëmbjen e pavarësisë dhe ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë. Kështu, në vitet 1941 dhe sidomos gjatë vitit 1942, në adresë të qeverisë dhe diplomacisë britanike, u dërguan një sërë letrash, telegramesh, peticionesh dhe memorandumesh nga figura të njohura, ku kërkohej të respektoheshin parimet e Kartës së Atlantikut. Midis tyre spikaste letra e mikes së Shqipërisë, E. Durham, e cila kritikonte indiferentizmin e qeverisë britanike ndaj fateve të këtij populli dhe kërkonte me forcë respektimin e pavarësisë dhe të integritetit të Shqipërisë.

Si detyrë të dorës së parë, diaspora shqiptare e Amerikës konsideroi përkrahjen dhe mbështetjen e përpjekjeve që bëheshin për formimin dhe për njohjen ndërkombëtare të një qeverie shqiptare në mërgim. Shumica e

<sup>1</sup> *Dielli*, “Italianët tallen me popullin shqiptar”, Boston Mass, 1 korrik 1940.

<sup>2</sup> *Po aty*. Në gazetën “Dielli” përmenden emrat e këtyre eksponentëve të fashizmit, Tefik Mborja dhe Ettore Mutti.

<sup>3</sup> *Po aty*, “S’ka faj Shqipëria, as populli i saj”, f. 2.

shqiptarëve të diasporës sonë e konsideronin këtë organizëm një faktor themelor juridik e politik për ruajtjen e legalitetit dhe statusit juridiko-territorial të shtetit shqiptar. Nga ana tjetër, krijimi i një qeverie të tillë, do të ishte faktor mobilizimi dhe organizimi i shqiptarëve në luftën çlirimtare si dhe do të siguronte mbrojtjen e interesave shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Krijimi i një qeverie shqiptare në mërgim ishte i domosdoshëm edhe për një arsye tjetër. Vendet fqinje i kishin ruajtur qeveritë e tyre në mërgim pas pushtimit të vendeve të tyre. Ata jo vetëm po mbronin me efektivitet interesat e tyre kombëtare, por po kryenin dhe veprimtari të ethshme politike e diplomatike për realizimin e synimeve të vjetra aneksioniste ndaj Shqipërisë.

E para tentativë për formimin e kësaj qeverie në mërgim, u bë vetëm pak ditë pas sulmit italian kundër Greqisë, duke theksuar se ky sulm “e kishte shtuar urgjencën e çështjes”<sup>4</sup>. Në mënyrë të natyrshme në epiqendër të këtyre përpjekjeve zinte vend të rëndësishëm mbartësi legjitim i sovranitetit të shtetit shqiptar, Ahmet Zogu.

Rryma të ndryshme të emigracionit, të mbështetura në motive sa kombëtare aq edhe juridike, e vlerësuan Zogun si figurë qendrore për krijimin e qeverisë shqiptare në mërgim. Madje, ai shihej si “përfaqësues legjitim i shtetit shqiptar dhe bartësi i vetëm i vazhdimësisë së tij konstitucionale”.<sup>5</sup> Sipas gjykimit të tyre, një qeveri me Zogun në krye, shihej edhe si garanci jo vetëm për rimëkëmbjen e pavarësisë, por edhe për paprekshmërinë e kufijve në fund të luftës. Në lëvizjen për krijimin dhe pranimin e një qeverie të tillë u përfshinë jo vetëm organizatat politike të emigracionit, që përfshinin Nolin, Konicën, Çekrezin, Zavalanin por edhe grupime të tjera emigrantesh.

Shqiptarët që punonin në industrinë e luftës në SHBA, me anë të një memorandumit, i kërkonin sekretarit të shtetit, C. Hullit, të pranonte një qeveri shqiptare në mërgim, nën kryesinë e mbretit A. Zogu<sup>6</sup>.

Edhe A. Zogu nga ana e tij, i kërkoi diplomacisë britanike, në mars të vitit 1942, të njihej si kryetar shteti në mërgim, pasi pozita e tij duhej të ishte e njëjlojtë me atë të mbretërve të Greqisë e të Jugosllavisë. Edhe pse kjo kërkesë u përsërit më vonë, në qershor 1942, nuk u pëlqye nga Forin Offisi britanik.<sup>7</sup>

<sup>4</sup> Foreign Office (më tej: F.O.), 371/24866. Kopje e letrës së Dervish Dumes dërguar Nolit dhe Nelo Dizdarit, kapur nga censura britanike, 6 nëntor 1940 (Referenca sipas Beqir Meta në: *Tensioni greko-shqiptar (1939-1949)*).

<sup>5</sup> F.O. 371/33109. Relacion i P. Dixonit mbi bisedën me Tajar Zavalanin, 3 korrik 1942.

<sup>6</sup> *United States National Archives* (më tej: USNA) DS. 875. 01/564, 1/2. Memorandum i shqiptarëve që punonin në industrinë e luftës, dërguar C. Hullit (pa datë).

<sup>7</sup> F.O. 371/33110. Raporte të Rajanit mbi bisedat me Zogun, 24 qershor dhe 4 korrik 1942.

Me sa dukej, qeveria britanike, në atë kohë, nuk e kishte përcaktuar qartë qëndrimin që do të mbante kundrejt çështjes shqiptare.<sup>8</sup>

Noli dhe Konica, si intelektualë me ndikim të rëndësishëm në diasporën shqiptare të Amerikës, i mbështetën përpjekjet e A. Zogut. Në vizitën e tyre në Departamentin e Shtetit amerikan, ata argumentuan domosdoshmërinë e krijimit të qeverisë, me Zogun në krye, si “personaliteti më i shquar shqiptar”<sup>9</sup>. Noli i shprehte C. Hullit shqetësimin se deklarata amerikane për pavarësinë e Shqipërisë, edhe pse ishte e shkëlqyer nga pikëpamja parimore, ishte e destinuar të mbetej në letër, në qoftë se nuk do të përforcohej (kjo deklaratë – M. D.) me garantimin e integritetit tokësor të Shqipërisë dhe me njohjen zyrtare të mbretit Zog si kryetar legjitim dhe logjik i qeverisë shqiptare në mërgim, së cilës t’i garantohej edhe një vend në Konferencën e Paqes.<sup>10</sup> Në këtë mënyrë, në përpjekjet e Zogut, për krijimin e qeverisë në mërgim, gjeti mbështetjen e vendosur të krerëve të shquar të organizatës më të fuqishme shqiptare në Amerikë, ”Vatrës”.

Pas vdekjes së Konicës, në dhjetor 1942, kohezioni i brendshëm i diasporës shqiptare në Amerikë, u trondit shumë, gjë që ndikoi në mënyrë të dukshme në përpjekjet për krijimin e qeverisë shqiptare në mërgim. Edhe Noli, tashmë, kishte bërë një tërheqje nga pjesëmarrja zyrtare në jetën politike shqiptare. Në këto rrethana, pas këtyre ndryshimeve që kishin ndodhur, ”antizogistet” apo “republikanët”, u tërhoqën nga pozicioni i mëparshëm, kur përkohësisht, kishin pranuar t’ua nënshtonin interesat e tyre politike, interesave kombëtare, duke mbështetur versionin e përbashkët, për krijimin e qeverisë në mërgim. Ata i përfshiu pasioni i mëparshëm i luftës kundër A. Zogut, pa marrë parasysh pasojat që do të kishte ky qëndrim në dëm të çështjes shqiptare. Megjithatë, Noli dhe vatanët, edhe pas kësaj situatë, mbajtën një qëndrim konstant, në mbështetje të çështjes shqiptare. Është i njohur telegrami i Nolit, dërguar C. Hullit, pas botimit të deklaratës britanike, ku theksonte se, ishte rreziku grek dhe mëdyshjet e deklaratës britanike që e bënin të nevojshme dhënien e garancive për pavarësinë e Shqipërisë.

Diaspora shqiptare e Amerikës i shprehte bindjen Departamentit të Shtetit amerikan se, “vetëm fronti i bashkuar shqiptar nën udhëheqjen e mbretit Zog, ishte mënyra më efektive, për të ndihmuar Shqipërinë dhe Kombet e Bashkuara”.<sup>11</sup>

<sup>8</sup> F.O. 371/33109/r4470/390/90. Shënime të Dixonit pas bisedës me T. Zavalanin, 3 korrik 1942.

<sup>9</sup> USNA. DS. F. W. 875. 01/427. Promemorie e Nolit dhe e Konicës pas vizitës në Departamentin e Shtetit, 19 nëntor 1942.

<sup>10</sup> *Po aty*.

<sup>11</sup> *Po aty*, DS. FW. 875. 01/474. Tel. i Shaqir Bucos, Asat Hasanit, Mehmet Kinakolicit, Hysen Panaritit etj., dërguar C. Hullit, 28 dhjetor 1942.

Rreziku grek për Shqipërinë ishte faktori kryesor që nxiste Nolin dhe vatanët për ruajtjen e trashëgimisë legale të Shqipërisë së paraluftës, pra, për njohjen e përfaqësuesit të shtetit shqiptar, A. Zogut, ndonëse kishte qenë kundërshtar politik i tij. Noli, i shqetësuar për pozitën e Shqipërisë, në raport me vendet fqinje, të cilat kishin në Londër e SHBA ambasadorë dhe qeveri në mërgim, kishte arsyetuar: “Zogu mund të konsiderohej si një autoritet që paraqiste një shpresë, se mund të pranohej nga Aleatët, si përfaqësues i vazhdimit të shtetit të pavarur shqiptar. Rrjedhimisht, rreth tij, mund të krijohesh një qeveri shqiptare në mërgim e cila mund të pranohej nga qeveritë amerikane dhe britanike, gjë që do të siguronte njohjen e Shqipërisë si komb i bashkuar dhe njohjen e pavarësisë dhe tërësisë tokësore pas luftës. Kjo, - vazhdonte arsyetimin Noli, - do të pengonte e do të thyente intrigat e pretendimet tokësore të qeverive shoviniste greke e jugosllave, në Londër”<sup>12</sup>.

Kundërshtarët e Zogut ose republikanët, tashmë bënë përçapje të krijonin një komitet kombëtar shqiptar ose, siç e quanin, “Komiteti i Shqipërisë së Lirë”, në vend të një qeverie, duke pranuar që komiteti të kishte në krye Zogun. Sipas republikanëve, ky Komitet (një organizëm pa prerogativat e qeverisë - M. D.), e linte të hapur çështjen e përcaktimit të formës së regjimit pas luftës, për të cilën ishin më shumë të shqetësuar ata. Për Zogun, përkrahja e kësaj ideje ishte vetëvrasje, por jo në planin personal. Pranimi i Komitetit, në vend të qeverisë, do t’u mohonte shqiptarëve të drejtat e fituara gjatë 20 vjetëve të shtetësisë së pavarur. Kjo rrezikonte që çështja shqiptare të shqyrtohej edhe një herë nga fillimi, pa patur asnjë siguri se rezultati do të ishte në interes të Shqipërisë. Prandaj, A. Zogu këmbëngulte në krijimin e qeverisë legale, si garanci për mbrojtjen e pavarësisë dhe të integritetit territorial të Shqipërisë<sup>13</sup>.

Politika britanike për të mos cenuar pretendimet territoriale greke kundrejt Shqipërisë, e përçau emigracionin politik shqiptar, lidhur me përpjekjet që ishin bërë për krijimin e një qeverie shqiptare në mërgim. Në këto rrethana të vështira për diasporën shqiptare, një pjesë e mirë e saj, e organizuar nga “Vatra”, ishte e bindur për pranimin pa kushte të mbretit Zog, si figura qendrore politike rreth së cilës duheshin bashkuar shqiptarët.<sup>14</sup> Ishte mikja e vjetër e Shqipërisë, zonja Edit Durham, atëhere 80 vjeç, që do t’i shkruante Fan Nolit, më 6 prill 1943, se “Ju gaboheni shumë kur mendoni se Shqipëria ka shumë miq në Angli. Partitë progreke e proserbe janë shumë më të fuqishme dhe me influencë ... Ata (shqiptarët – M.D.), nuk duhet t’i varin shpresat për shpëtim tek miqtë anglezë, por duhet të fitojnë simpatinë dhe përkrahjen e Amerikës, nëse dëshirojnë që Atdheu i tyre, të mos copëtohet, e të mos u hidhet

<sup>12</sup> Behar Shtylla, *Noli siç e kam njohur unë*, Tiranë: 1997, f. 112.

<sup>13</sup> F.O. 371/37137. Kopje e letrës së Sotir Martinit drejtuar Tajar Zavalanit, 11 maj 1943.

<sup>14</sup> F.O. 3711/37137. Letër e T. Zavalanit dërguar Mis. Barkerit, 24 tetor 1943.

si shpërblim armiqve”. Dhe së fundi uronte: “Zoti e shpëtoftë Shqipërinë!”<sup>15</sup>. Pikërisht, në këtë kohë, në diasporën shqiptare u shpenzua shumë kohë dhe energji e panevojshme brendapërbrenda, duke zbehur e zvarritur përpjekjet, për të kundërshtuar propagandën dhe ofensivën diplomatike të qeverisë greke, në Londër dhe në Uashington, me synime të qarta antishqiptare.

Situata ndryshoi në mënyrë të shpejtë e të vrullshme në verë të vitit 1944. Fashizmi po merrte goditjet vendimtare por edhe rreziku komunist për Shqipërinë po bëhej gati i sigurt. Nga ana tjetër, ofensiva politike e diplomatike greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut po intensifikohej. Përpara këtij rreziku, shqiptarët e Amerikës, të mbledhur në një miting, miratuan një rezolutë për Fuqitë e Mëdha dhe Kombet e Bashkuara.<sup>16</sup> Rezoluta kërkonte njohjen zyrtare të qeverisë shqiptare në ekzil, ashtu siç kishte ekzistuar para 7 prillit 1939, si dhe pranimin e Shqipërisë me të drejta të plota në KB. Për rrezikun që i paraqitej Shqipërisë, “Vatra” i bënte gjithnjë e më tepër të ndërgjegjshëm bashkatdhetarët e vet. Prandaj, nëpërmjet organit të saj, gazetës “Dielli”, u kujtonte atyre se, Vatra kishte mbajtur qëndrim kritik ndaj politikës britanike që në vitin 1942, pas deklaratës së A. Edenit në dhjetor të këtij viti. Kjo deklaratë “u muar nga grekët si një ftesë dhe ata shpejtuan të përgatitin dasmën për copëtimin e Shqipërisë. Deklarata e zotit Eden, - shkruante Dielli, - u përhap si një sëmundje ngjitime në të gjitha anët dhe nuk la asnjë grek gjëkund pa zënë. Këtu në Amerikë, grekomanët “epirotë” hapën kuletat dhe nisën përsëri nga avazi vjetër, me shpresë që t’i mbushnin kokën popullit amerikan se shqiptarët janë grekë”<sup>17</sup>.

Epërsia e forcave që drejtoheshin nga komunistët në ngjarjet politike ushtarake, në fund të verës 1944, ndikoi dhe në qëndrimin e një pjese të mirë të diasporës shqiptare në Amerikë. Ata duke e ndjerë thellë presionin dhe rrezikun grek në Shqipërinë e Jugut, si një çështje që kishte të bënte drejtpërdrejt me interesat kombëtare, “Vatra” e mbështeti qeverinë komuniste, të drejtuar nga Enver Hoxha, ashtu siç kishte kërkuar, më parë, krijimin e frontit të përbashkët shqiptar. Duke iu referuar krijimit të qeverisë së Beratit (tetor 1944), “Vatra” kërkoi me insistim njohjen e saj nga Aleatët. Ajo e kritikonte qëndrimin për mosnjohjen e saj, duke u shprehur se, “Kjo është një tradhti e idealeve të Kombeve të Bashkuara. As më pak e as më shumë. Kjo tradhti duhet ndrequr sa më shpejt”.<sup>18</sup>

<sup>15</sup> Mehdi Manç Bushati, “Pse nuk u krijua qeveria shqiptare në mërgim”, në përmbledhjen: *100-vjetori i lindjes së mbretit Zog I*, Tiranë: 1995, f.65-66.

<sup>16</sup> F.O. 371/43555/R 179/71/90. Tel. dërguar A. Edenit nga Kryesia e Komitetit për Çlirimin e Shqipërisë (Christ Lepon, Petro Danushi, Christ Skurte, Ismail Emini, Angelo Peters), 9 qershor 1944.

<sup>17</sup> *Dielli*, “Toskëria sot”, 18 nëntor 1944.

<sup>18</sup> *Po aty*, “Lajme nga Shqipëria”, 2 dhjetor 1944.

---

Edhe në rrethanat komplekse e të ndërlikuara të Luftës së Dytë Botërore, ku interferonin faktorë të brendshëm e të jashtëm që rrezikonin, tërësinë dhe integritetin e shtetit shqiptar, diaspora shqiptare mbajti një qëndrim permanent në shërbim të çështjes kombëtare, pa marrë në konsideratë ndikimet ideologjike të forcave që qeverisnin në Shqipërinë e pasluftës. Për ta kishte rëndësi që vendi të kishte një qeveri që t'i dilte në mbrojtje ruajtjes së tërësisë dhe integritetit të saj. Më vonë, kur Shqipëria po futej në rrugën e vendosjes së diktaturës komuniste diaspora shqiptare nuk e mbështeti qeverinë komuniste për qëndrimet dhe veprimet antidemokratike të saj ndaj shqiptarëve.

